VENDIM
Nr. 313, datë 15.5.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E VETËQEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 86, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, t'i shtohet fondi prej 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Efekti financiar prej 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekësh, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe